

**AKT THEMELIMI
(KONTRATË)**

**I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“KORABI-NET. Sh.P.K.”**

Unë, Themeluesi, **Engjëll MELANI**, i biri i Ramazanit, lindur me **03.11.1981** në Peshkopi/Dibër, banues në Lagjen “Treg”, Sheshi “Faik Shehu”, banesa në objektin Nr.16, Z.K.Nr.2932, qyteti Peshkopi, zotërues i Kartës së Identitetit **nr.personal/personal no.I11103006I**

V E N D O S A

Neni 1

Të themeloj një Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar për të ushtruar veprimtari ekonomike të EMËRTUAR : “KORABI-NET. Sh.P.K.”

Neni 2

Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërive Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar dhe përballon humbjet deri në kufirin e vlerës së derdhur në kapitalin themeltar.

Neni 3

Shoqëria e ka SELINË në Bashkinë e qytetit Peshkopi në adresën : Lagjja “Treg”, Sheshi “Faik Shehu”, objekti Nr.16 në anën jugore të rrugës, Z.K. Nr.2932

Ajo ka të drejtë të krijojë brenda dhe jashtë teritorrit të Republikës së Shqipërisë, filiale, agjensi, përfaqësi, seli sekondare dhe t'i suprimojë ato.

Neni 4

Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje me një kufi të pacaktuar, **mbi 15 vjet.**

Neni 5

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është : **1000 Lek (Njëmijëlekë).**

Kapitali i shoqërisë zotërohet nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë, **Engjëll MELANI.**

Ortaku i Vetëm **Engjëll MELANI, zotëron 100 %** të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga **1 kuotë(pjesë),** me vlerë totale prej **1000 Lek (Njëmijëlekë).**

Kapitali Themeltar prej **1000 Lek (Njëmijëlekë).** ndahet **në 1 kuotë(pjesë) me vlerë nominale 1000 Lek (Njëmijëlekë).**

Neni 6

Në librin e llogarisë që do të krijohet në Shoqërinë Tregtare do të shënohet dhe kapitali i derdhur nga Ortaku i Vetëm.Rritja e kapitalit nuk është e kufizuar.

Neni 7

Të gjitha pjesët e kapitalit themelor janë tërësisht të shlyeshme dhe të nënshkrueshme nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë.

Neni 8

OBJEKTI I VEPRIMTARISË DO TË JETË :

Shërbime interneti dhe aksesore.Shtrim dhe montim linjash telefonike, interneti, platforma dixhitale.Shtrim dhe montim sistemesh sigurie, kamera vëzhgimi e të ngjashme.Ngritje agjensie për udhëtime dhe transport.Hapje bar-kafe, restorant, bujtina, hoteleri e të ngjashme.

Neni 9

Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit që lidhet midis palëve në mbështetje të Ligjit Nr.7961 Dt.12.07.1995, "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", si dhe akteve të tjera nënligjore të dala në zbatim të tij.

Neni 10

Ortaku i Vetëm i shoqërisë **nuk kufizohet në rritjen e kapitalit të shoqërisë.**

Neni 11

Shoqëria vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejta e detyrime vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortaku i Vetëm Themelues mbart rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë vetëm në nivelin e kapitalit të investuar në shoqëri.

Neni 12

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private të shoqërisë, midis punonjësve brenda saj dhe me të tretët, kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, atëherë ato zgjidhen me rrugë gjyqësore në gjykatën kompetente.

Neni 13

Shoqëria do të ketë vulën e saj ku janë përcaktuar dhe inicialet e emërtimit të shoqërisë.

Neni 14

Pasuria e shoqërisë mund të sigurohet pranë shoqërive të sigurimit duke respektuar ligjet që veprojnë në fushën e sigurimit dhe risigurimit.

Neni 15

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

NENI 8

ORGANI VENDIMMARRËS JANË

- Asambleja e Ortakëve (Ortaku i Vetëm)
- Administratori/ët i (e) shoqërisë

Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në Statutin e shoqërisë.

Administrator i shoqërisë do të jenë **Z. Engjëll MELANI.**

Modalitetet për ndryshimin e Administratorit/ve si dhe kompetencat rregullohen nga **Statuti i Shoqërisë dhe Ligji Nr 9901 Dt.14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".**

Ky Akt Themelimi është përpiluar në katër kopje me vlerë të njëjtë me origjinalin.

THEMELUESI I SHOQËRISË TREGTARE

"KORABI-NET. Sh.P.K."

Engjëll MELANI

Engjëll Melani

Peshkopi, me 12.02.2019